

E v i t a sh.p.k

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare Individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

Përmbajtja

Faqja

Raporti i Audituesit të Pavarur	i-iii
Pasqyra individuale e pozicionit financiar	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra individuale e flukseve të parasë	3
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	4
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale	5-33

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	6	714,029,537	749,737,511
Aktive afatgjata jo-materiale	7	3,699,525	4,932,698
Investime në pjesëmarrje	8	111,155,223	112,080,212
Aktivitet tatimore të shtyra	27	-	180,352
Aktive me të drejtë përdorimi	9	72,400,582	41,812,103
Totali i aktiveve afatgjata		901,284,867	908,742,876
Aktive afatshkurtra			
Inventari	10	363,150,646	427,829,745
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	1,591,851,549	1,438,785,498
Aktive financiare afatshkurtër	12	307,210,827	337,116,907
Tatim fitimi i parapaguar	27	15,347,179	36,631,139
Aktive të tjera	13	28,919,868	16,423,547
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	14	28,554,564	18,517,221
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,335,034,627	2,275,304,057
TOTALI I AKTIVEVE		3,236,319,494	3,184,046,933
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nënshkruar dhe primi i kapitalit	15	123,000,000	123,000,000
Fitime të mbartura		1,421,043,201	1,756,368,268
Fitimi i vitit		197,432,508	131,078,093
Totali i kapitalit		1,741,475,709	2,010,446,361
Detyrime afatgjata			
Huamarrje afatgjatë	16	49,953,184	61,208,924
Detyrime për qiratë	17	56,163,294	26,327,007
Detyrime tatimore të shtyra	17	125,804	-
Totali i detyrimeve afatgjata		106,242,282	87,535,931
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	18	279,836,200	216,325,328
Detyrime për qiratë	17	15,398,594	16,687,441
Huamarrje afatshkurtër	16	283,537,111	267,126,410
Detyrime financiare të tjera afatshkurtër	19	619,932,879	392,500,787
Detyrime për tatimin aktual	20	10,774,406	15,464,833
Detyrime të përlogaritura dhe parapagime	21	179,122,313	177,959,842
Totali i detyrimeve afatshkurtra		1,388,601,503	1,086,064,641
DETYRIME TOTALE		1,494,843,785	1,173,600,572
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		3,236,319,494	3,184,046,933

Pasqyra individuale e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqa 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Aktivitetet e vazhdueshme			
Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	2,027,430,933	2,260,555,164
Të ardhura të tjera	23	116,011,795	23,021,217
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(1,428,044,981)	(1,645,099,129)
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	6,7,9	(105,002,760)	(107,938,549)
Shpenzime personeli	24	(181,068,114)	(199,966,002)
Shpenzime financiare neto	25	(72,764,317)	(65,024,078)
Shpenzime administrative	26	(122,690,557)	(103,945,159)
Fitimi para tatimit		233,871,999	161,603,464
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	27	(36,133,335)	(29,638,929)
Shpenzime tatimore të shtyra	27	(306,156)	(886,442)
Fitimi i periudhës nga aktiviteti i vazhdueshëm		197,432,508	131,078,093
Fitimi i periudhës		197,432,508	131,078,093
Të ardhura nga rivlerësimi i aktiveve		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		197,432,508	131,078,093
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për:			
Zotëruesit e njesisë ekonomike mëmë		143,138,568	95,031,617
Interesat e pakicës		54,293,240	36,046,476

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtimi i Shoqërisë më 25.03.2025 dhe janë firmosur nga:

Administrator

Alqi Jani

Alqi Jani

Drejtore i Financës

Emirljana Erden

Emirljana Erden

Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqa 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

E v i t a sh.p.k

Pasqyra individuale e flukseve të parasë

(vlerat janë të shprehura në lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Fluksi i mjeteve monetare nga/përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit:			
Fitimi para tatimit	27	233,871,999	161,603,464
Regullime për të ardhura dhe shpenzime jo-monetare:			
Shpenzimet financiare jomonetare	25	83,067,293	89,520,650
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,7,9	24,832,383	23,463,561
Ndryshim në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit			
Rënie/rënie në të drejtat e arketueshme dhe të tjera		(153,066,052)	(10,843,940)
Rritje/rritje në inventar		64,679,099	118,070,396
Rritje/rritje në të drejtat të tjera		38,693,719	154,204,445
Rritje/rritje në detyrime të pagueshme		202,620,177	299,633,846
Rritje/rënie në te pagueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit		63,510,873	(92,982,958)
Mjete monetare të përfituara nga aktivitetet		558,209,491	742,669,464
Interesi i paguar		(24,832,383)	(23,463,561)
Tatim mbi fitimin i paguar		(14,849,375)	(18,839,864)
Mjete monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		518,527,733	700,366,039
Fluksi i mjeteve monetare nga/ përdorur në aktivitetin e investimit			
Investime ne shoqerite e kontrolluara		924,990	(11,079,636)
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(117,891,814)	(168,880,027)
Shitja e pajisjeve/nxjerrja jashte perdorimit		41,177,192	39,205,562
Rritje kapital Themeltar/ Pagese dividenti		(466,403,161)	(466,408,951)
Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e investimit		(542,192,797)	(607,163,052)
Fluksi i mjeteve monetare nga/përdorur në aktivitetin e financimit			
Hyrje nga huamarrje afatgjata/afatshkurtra		33,702,401	-
Pagesat e detyrimeve të huase dhe qirasë financiare		-	(100,205,150)
Mjete monetare neto nga/përdorur në aktivitetin e financimit		33,702,401	(100,205,150)
Rritje/(rënie) neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		10,037,341	(7,002,163)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fillim		18,517,221	25,519,384
Mjete monetare dhe ekuivalente me to në fund	14	28,554,562	18,517,221

Pasqyra individuale e flukseve të parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqa 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Evita sh.p.k

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

(vlerat janë të shprehura në lek)

Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022

Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:

Fitim/(humbja) e periudhës

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën

Emetim i kapitalit të nënshkruar

Dividend të shpërndarë

Përcaktime të tjera për rezultatit e periudhës

Totali i transaksioneve për pronaret e njësisë ekonomike

Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023

Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse të periudhës:

Fitim/(humbja) e periudhës

Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën

Emetim i kapitalit të nënshkruar

Dividend të shpërndarë

Përcaktime të tjera për rezultatit e periudhës

Totali i transaksioneve për pronaret e njësisë ekonomike

Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024

Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitim/(humbja) e periudhës	Totali
123,000,000	1,885,490,750	337,286,469	2,345,777,219
-	-	131,078,093	131,078,093
-	(466,408,951)	131,078,093	131,078,093
-	337,286,469	-	(466,408,951)
-	(129,122,482)	(337,286,469)	-
123,000,000	1,756,368,268	131,078,094	2,010,446,361
-	-	197,432,508	197,432,508
-	(466,403,160)	197,432,508	197,432,508
-	131,078,094	-	(466,403,160)
-	(335,325,066)	(131,078,094)	-
123,000,000	1,421,043,202	66,354,414	(268,970,652)
123,000,000	1,421,043,202	197,432,507	1,741,475,709

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqa 5 deri në 33, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

E v i t a sh.p.k. është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me akt themelimi datë 10.05.2013 të Regjistrat Tregtar, në përputhje me ligjin Nr 9901 datë 14.04.2008 “ Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Kapitali themeltar i shoqërisë është 123,000,000 lekë. Shoqëria është e regjistruar si person juridik në Degën e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NIPT L31714005J. Selia e shoqërisë është Rruga Sami Frashëri, Nr. Pasurie 7/120- N1, Zona Kadastrale 8270, Vol. 28, faqe 155.

Shoqëria ofron aktivitet import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të produkteve farmaceutike, kozmetike, bimëve medicinale, instrumentave dhe pajisjeve shëndetësore dhe medicinale, sanitare, shtesa ushqimore dhe dietike duke përfshirë import, eksport, tregtimi me shumice, montim dhe riparim i aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, impianteve si dhe aksesoreve të tyre, investime, shërbime, projekte në fushën e mjeksisë dhe shëndetit.

Ortakët e shoqërisë janë si më poshtë:

Arimo BV	72.5% me vlerë 89,175,000 lek
Ertel Kërçuku	27.5% me vlerë 33,825,000 lek

Kapitali i shoqërisë është 123,000,000 lekë si kontribut nga fondet e vetë ortakëve.

E v i t a sh.p.k ka investuar në shoqëritë si më poshtë:

Shoqëria	Përqindja	Vlera e Kapitalit
Pharma One	34%	LEK 95,310,939
Skopster Doo Skopje	62.5%	EURO 160,829
Biohit MDS sh.p.k	60%	EURO 600

Administratori i shoqërisë është z. Alqi Jani.

Numri mesatar për vitin 2024 është 76 punonjës, ndërsa për vitin 2023 ishte 77 punonjës.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) referuar në vijim si “Pasqyra Financiare”.

Detajet e politikave kontabël të Shoqërisë janë të përfshira në Shënimin 5.

(b) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në bazë të kostos historike.

(c) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare përgatiten në përputhje me parimin e vijueshmërisë, i cili nënkupton se Shoqëria do të vazhdojë operacionet e saj në një periudhë kohe të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikueshme.

2. Baza e përgatitjes – (vazhdim)**(d) Filialet dhe konsolidimi**

Filialet janë njësi të kontrolluara nga Shoqëria. Kontrolli ekziston kur Shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, që të qeverisë politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme. Shoqëria përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF. Shoqëria ka kontroll mbi Skopster Doo Skopje and Biohit MDS shpk në nivelin 62.5% dhe 60% respektivisht. E v i t a ka fuqinë vendimarrëse, të drejtat ndaj kthimeve variabël dhe aftësinë për të përdorur fuqinë vendimarrëse për të ndikuar këto kthime variabël. Në pasqyrat financiare të konsoliduara, Degët si edhe Shoqëritë e Kontrolluara, në te cilat Grupi kontrollon në mënyrë direkte ose jodirekte më shumë se gjysmën e të drejtave të votës, ose zoteron të drejtën për të ushtruar kontroll mbi aktivitetet e tyre, konsolidohen plotësisht.

Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare individuale duhet të lexojnë këto pasqyra si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 për të marrë informacion mbi pozicionin financiar, performancën financiare dhe ndryshimeve në pozicionin financiar të Grupit në tërësi.

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare individuale kontabilizohen me kosto.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera kontabël e mbetur e tyre mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse vlera e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël neto reduktohet në shumën e rikuperueshme.

Vlera kontabël e mbetur e një investimi çregjistrohet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit nga shitjet dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta gjë vlen edhe nëse nxjerrja jashtë përdorimit rezulton në kalimin nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose në pjesëmarrje të matur me kosto.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Këto Pasqyrat Financiare Individuale janë paraqitur në monedhen vendase Lekë, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Shoqërisë.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i Shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga çmuarjet. Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve njihen në mënyrë prospektive.

5. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të njëjtë në të gjithë periudhat të paraqitura në këto pasqyra financiare, përveçse nëse përmendet ndryshe.

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhe të huaj janë konvertuar në monedhen funksionale me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të dates në të cilin është kryer transaksioni. Aktivët dhe pasivët monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i konvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Regjistrimet kontabël të shoqërisë përgatiten në Lekë që është monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Shoqëria.

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen në monedhën Lek, duke aplikuar mbi monedhën e huaj kursin e momentit të këmbimit të kësaj monedhe me Lek-un në datën e veprimt. Aktivët monetare dhe detyrimet në monedhë të huaj në datën e raportimit të pasqyrave financiare konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në atë datë. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja/pagesa e mjeteve monetare ose nga konvertimi i mjeteve monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga ato që janë përdorur në njohjen fillestare gjatë periudhës ushtrimore aktuale ose në pasqyrat financiare individuale të mëparëshme, njihen si fitim ose humbje e periudhës ushtrimore kur ndodh diferenca. Mjetet jo-monetare që njihen me kosto historike në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e veprimt, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë janë të vlerësuar me kursin e këmbimit në datën kur vlera e drejtë është vendosur. Diferencat e këmbimit nga rivlerësimi në datën e bilancit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kurset e këmbimit më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 janë:

Monedha	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
EURO/LEK	98.15	103.88
USD/LEK	94.26	93.94

b) Instrumentat Financiare

Njohja dhe matjet fillestare

Shoqëria njeh kërkesën për arkëtim fillimisht në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivët dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit. Një aktiv financiar (përveç nëse është një kërkesë për arkëtim që nuk përmban një element të rëndësishëm financimi) ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, me koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit. Një kërkesë për arkëtim tregtare që nuk përmban një element të rëndësishëm financimi njihet fillimisht me koston e transaksionit.

5. Politika materiale kontabël – (vazhdim)**b) Instrumentat Financiare – (vazhdim)***Klasifikimi dhe matjet e mëposhtme**Aktivitet financiar*

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGJ; ose me VDPFH. Aktivitet financiar nuk riklasifikohet pas njohjes fillestare, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivitetet financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar me VDPFH:

- është në një model biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja e aktiveve për përfitimin e flukseve monetare kontraktuale; dhe
- termat kontraktuale të aktivitetit përcaktojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principali dhe interesit mbi shumën totale të pashlyer në data specifike.

Aktivitet financiar - Vlerësimi i modelit të biznesit:

Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në një nivel portofoli, sepse kjo mënyrë reflekton saktë drejtimin e biznesit dhe informacionin që i ofrohet Drejtimin. Informacioni përfshin:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë. Këto përfshijnë nëse strategjia e drejtimin fokusohet në fitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, duke ruajtur një profit të caktuar të normës së interesit, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve të lidhura me to ose daljen e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- se si performanca e portofolit vlerësohet dhe raportohet tek drejtimi i Shoqërisë;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe aktivitetet financiare të mbajtura brenda atij modeli të biznesit) dhe në veçanti, mënyra në të cilën këto rreziqe janë menaxhuar;
- si janë kompensuar drejtuesit e biznesit, nëse kompensimi është i bazuar në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në bazë të flukseve monetare kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuenca, volumi dhe koha e shitjes së aktiveve financiare në periudha të mëparshme, arsyet e shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjes.

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për regjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Shoqërisë.

5. Politika materiale kontabël – (vazhdim)

b) Instrumentat Financiare – (vazhdim)

Klasifikimi dhe matjet e mëpasshme

Aktivet financiare - Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit:

Për qëllim të këtij vlerësimi, ‘principal’ është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. ‘Interesi’ është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhë kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh, rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit. Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Shoqëria merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin. Gjatë vlerësimit, Shoqëria konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare; - kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme).

Një tipar parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesës vetëm për principalin dhe interesin nëse shuma e parapaguar në thelb paraqet shumën e papaguar të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Gjithashtu, për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përlloritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

Aktivet financiare - Matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet:

Aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar rrjedhimisht maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kostoja e amortizuar reduktohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.

Instrumente të kapitalit me VDATGJ - Matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet:

Shoqëria, në momentin fillestar të njohjes së një investimi në një instrument kapitali i cili nuk është i mbajtur për tregtim, mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ndryshimet e mëpasshme në vlerën e drejtë të investimit. Kjo zgjedhje bëhet në bazë të secilit investim. Fitimet ose humbjet nga instrumente të kapitalit nuk riklasifikohen asnjëherë në fitim ose humbje dhe asnjë zhvlerësim i tyre nuk njihet në fitim ose humbje. Dividendët nga investimi njihen në fitim ose humbje. Fitimet dhe humbjet e akumuluar në njohura në të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse kalojnë në fitimet e pashpërndara në reduktim të investimit, dhe nuk riklasifikohen asnjëherë në fitim ose humbje.

5. Politika materiale kontabël – (vazhdim)**b) Instrumentat Financiare – (vazhdim)***Detyrimet financiare - Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet*

Detyrimet financiare maten fillimisht me koston e amortizuar dhe pas njohjes fillestare ato maten me koston të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

Instrumentet e kapitalit - Matja

Instrumentet financiare të vlefshme për shitje përfaqësojnë investime në kapital të matur me kosto për mungesë të të dhënave mbi vlerën e tyre të drejtë. Në vijim të njohjes fillestare, ato janë matur me koston neto nga humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

*Çregjistrimi**Aktivitet financiare*

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktiviteti financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar. Shoqëria bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivitetet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivitetet e transferuara nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe flukset e mjeteve monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca midis vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv financiar të transferuar apo detyrime të marra) njihet në fitim ose humbje.

Netimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të shlyer shumën dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivitetin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

5. Politika materiale kontabël – (vazhdim)

c) Zhvlerësimi i aktivet financiare jo-derivative

Shoqëria njeh një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe e mat zbritjen në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivit. Shoqëria e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Shoqërisë pa masa shtrënguese nga ana e Shoqërisë siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

Matja e HPK

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që duhet t'i paguhet Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe flukseve të mjeteve monetare që Shoqëria pret të marrë).

Aktivitet financiare të zhvlerësuar

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar është zhvlerësuar nëse ka ndodhur një ose më tepër ngjarje që kanë ndikim të ndjeshëm në flukset monetare të ardhshme. Të dhënat e verifikueshme që tregojnë se një aktiv financiar është i zhvlerësuar janë:

- vështirësi të mëdha financiare të debitorit;
- shkelje e kontratës ose debitori është më tepër se 90 ditë me vonesë në kryerjen e pagesës;
- është e mundur që debitori do të falimentojë ose do të riorganizohet financiarisht.

Paraqitja e zbritjes për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar.

Humbjet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të aktivit financiar. Shoqëria bën një vlerësim individual në lidhje me kohën dhe shumën e fshirjes duke patur parasysh mundësinë e arsyeshme të rikuperimit. Shoqëria nuk pret rimarrje të konsiderueshme nga shuma e fshirë. Megjithatë, aktivet financiare që janë fshirë mund të jenë ende subjekt i masave shtrënguese në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave të pashlyera.

5. Politika materiale kontabël – (vazhdim)**d) Aktivitet Afatgjata Materiale***Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Programet kompjuterike të blera, të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të pajisjes përkatëse, kapitalizohen si pjesë e saj. Kur pjesë të një elementi të aktiveve të trupëzuara kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve të trupëzuara. Të ardhurat dhe humbjet nga shitja e një aktivi të trupëzuar përcaktohen duke krahasuar të hyrat nga shitja e aktivitet me vlerën kontabël të tij dhe njihen me vlerë neto tek “të ardhura të tjera”/” shpenzime të përgjithshme dhe administrative” në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (në fitim ose humbje).

Kostot vijuese

Nëse është e mundshme që përfitime ekonomike që i atribuohen një elementi të aktiveve të trupëzuara do të rrjedhin në të ardhmen në Shoqëri dhe kostoja e tij mund të matet në mënyrë të besueshme, kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve të trupëzuara njihet me vlerën kontabël të elementit. Vlera e mbetur e aktiveve të zëvendësuara çregjistrohet. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve të trupëzuara njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) në momentin kur ato ndodhin.

Amortizimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse (fitim ose humbje) dhe llogaritet me metodën lineare sipas jetëgjatësisë së çdo pjese apo njësie të aktiveve të trupëzuara. Aktivitet e marra me qira zhvlerësohen sipas më të voglës midis jetëgjatësisë së aktivitet dhe kohës së huasë, përveçse kur që është e qartë se Shoqëria do të fitojë pronësinë në përfundim të kontratës së qirasë. Toka nuk zhvlerësohet.

5. Politika materiale kontabël – (vazhdim)

d) Aktivet afatgjata materiale– (vazhdim)

Normat e zhvlerësimit për periudhën aktuale dhe periudhën krahasuese janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Metoda Lineare	5%
Makineri e pajisje	Metoda Lineare	20%
Mjete transporti	Metoda Lineare	20%
Pajisje zyre	Metoda Lineare	20%
Pajisje kompjuterike	Metoda Lineare	25%

Metodat e amortizimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur e aktiveve të trupëzuara rishikohen në çdo datë raportimi.

e) Aktivet afatgjata jo materiale

Aktivët afatgjata jo materiale përfshijnë licencat, programet, websit-et dhe të drejtat për përdorim.

(i) Njohja dhe matja

Aktivët e patrupëzuara paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

(ii) Kostot vijuese

Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metoden lineare mbi jetëgjatësinë e parashikuar të aktiveve të patrupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim. Në vecanti amortizimi për programet, janë llogaritur me normën fiskale 25%.

f) Qiratë

Shoqëria si qiramarrës

Shoqëria zbaton një njohje dhe model matjeje të vetme për të gjitha qiradhëniet përveçse qirave afatshkurtra dhe qirave me aktiv me vlerë të vogël. Shoqëria njihet detyrimet e qirasë për të bërë pagesa të qirasë dhe aktive me të drejtë përdorimi që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të aktiveve në fjalë.

(vlerat në lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

5. Politika materiale kontabël – (vazhdim)

f) Qiratë – (vazhdim)

Aktiv me të drejtë përdorimi

Shoqëria njihet aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë. Aktiv me të drejtë përdorimi matet me kosto duke zbritur amortizimin apo humbjet nga zhvlerësimi duke u rregulluar me çdo rivlerësim të detyrimit të qirasë. Kostoja e aktiveve me të drejtë përdorimi përfshin totalin e detyrimeve të qirasë të njohur, kostot direkte fillestare të bëra dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, duke e pakësuar me çdo stimul të qirasë të marre. Aktivet me të drejtë përdorimi zhvlerësohen në bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Aktiv me të drejtë përdorimi janë paraqitur në shënimin 9. E drejta e përdorimit të aktiveve.

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njihet detyrimet e qirasë, të matura në vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të kryhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse (minus çdo stimul të arkëtueshëm), pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, dhe shumat që pritet të paguhet nën garancitë e vlerës së mbetur. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje në mënyrë të arsyeshme që do të ushtrohet nga Shoqëria dhe pagesa të gjobës për ndërprerjen e qirasë, nëse qiraja reflekton ushtrimin e opsionit për të përfunduar. Pagesat e bëra të qiradhënies operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Stimujt e marrë nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit të përgjithshëm të qirasë, gjatë afatit të qirasë. Detyrimet e qirasë paraqiten nën zërin detyrime të tjera.

g) Inventarët

Inventarët mbahen me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarëve bazohen në metodën “hyrja e parë, dalja e parë” dhe përfshin shpenzimet që ndodhin në blerjen e tyre, prodhimin ose këmbimin dhe kosto të tjera për t’i sjellë ato në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese. Kosto përfshin edhe një pjesë të përshtatshme të kostove operacionale bazuar në kapacitetin normal operacional. Vlera neto e realizueshme është çmimi i parashikuar i shitjes në aktivitetin normal të biznesit duke hequr kostot e përfundimit dhe shpenzimet e shitje.

h) Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase (mjetet monetare) përfshijnë tepricat e arkës, llogaritë rrjedhese dhe depozitat në bankat. për qellime të pasqyrës së fluksit të parase, paraja dhe ekuivalentet të saj përfshijnë depozita pa afat dhe ato me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data fillestare.

i) Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe me pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen e pritshme të kredise. Gjatë vitit 2024 ka filluar aplikimi i SNRF 9. Shoqëria ka kontabilizuar humbje të parashikuara të kredise për aktivet financiare.

5. Politika materiale kontabël – (vazhdim)**j) Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe me pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metoden e interesit efektiv nese është materiale.

k) Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e drejte, pa përfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo difference midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Fitimet dhe humbjet njihen në pasqyren e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe detyrimet financiare të mesipërme zhvlerësohen sikurse dhe nepërmjet procesit të amortizimit.

l) Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivative maten me kosto të amortizuar sipas metodes së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

m) Provizionet

